REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN
KRYETARI

Nr. 1676 prot. Laç, më 03.04.2025

VENDIM
Nr. 02, datë 03/04.2025

"PËR PËRCAKTIMIN E VENDEVE PUBLIKE NË TERRITORIN E BASHKISË KURBIN PËR AFISHIMIN E MATERIALEVE EDUKATIVE ZGJEDHORE DHE TË MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE".

Në mbështetje të nenit 113, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 79 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikes së Shqipërisë, të ndryshuar, të ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ligjit nr.8580, datë 17.2.2000 "Për partitë politike" të ndryshuar, të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës" të ndryshuar, si dhe të Udhëzimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr.6, datë 23.03.2021 "Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore",

VENDOSA:

1. Pranë ambienteve të çdo Njësie Administrative të Bashkisë Kurbin të kryhet afishimi i materialeve edukative zgjedhore, në dispozicion të KQZ-së, ose palëve të treta që nuk promovojnë fushatën e një subjekti, të caktuar zgjedhor, por që i shërbejnë edukimit të zgjedhësve, lidhur me të drejtat e tyre dhe procedurat e regjistrimit dhe të votimit sipas Kodit Zgjedhor.

2. Në vendet e afishimit të percaktuara sipas pikës 1 të këtij vendimi subjektet zgjedhore lejohen të afishojnë vetëm materiale të programeve të tyre zgjedhore.

3. Gjatë fushatës zgjedhore përdorimi dhe afishimi i çdo materiali tjetër statik për propagandë zgjedhore, përfshirë flamujt dhe posterat, lejohet vetëm në një largësi prej deri 5 metrash nga zyra zgjedhore e partisë politike apo subjektit zgjedhor përkatës.

4. Te gjitha materialet propagandistike vizive qe perdoren ne fushate duhet te shoqerohen me shenimin: "Prodhuar nen pergjegjesine ligjore te ..... " (vijon emri i subjektit zgjedhor).

5. Pas marrjes së informacionit nga subjektet zgjedhore për adresat e sakta të zyrave elektorale, brenda 5 ditëve të bëhet verifikimi i vendndodhjes së tyre dhe të respektimit të dispozitave të Kodit Zgjedhor dhe të Udhëzimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr.6, datë 23.03.2021 "Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore".

6. Policia Bashkiake në bashkëpunim me Policinë e Shtetit merr masa të menjëhershmë për të hequr çdo material propagandues të subjekteve zgjedhore të vendosura në kundërshtim me nenin 79 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikes së Shqipërisë, të ndryshuar, të Udhëzimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr.6, datë 23.03.2021 "Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore", si dhe me këtë vendim.
7. Ngarkohet për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi Njësitë Administrative të Bashkisë Kurbin, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Burimeve Njerëzore/Specialisti IT dhe Policia Bashkiake.
8. Ky vendim i njoftohet Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet, brenda 24 orësh nga miratimi i tij.
9. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të Bashkisë Kurbin.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Majlinda Cara

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA KURBIN

Adresa: Lagjia Nr.3, Laç E-mail bashkiakurbin@gmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN

KRYETARI

Nr. 1676/1 prot. Laç, më 03.04.2025

Lënda: Vendet e lejuara për afishimin e materialeve propagandistike.

Vendet e lejuara në territorin e Bashkisë Kurbin për afishimin e materialeve edukative zgjedhore dhe të materialeve propagandistike sipas vendimit nr.2, datë 03.04.2025 do të jenë si më poshtë:

1. Afishimi i materialeve edukative zgjedhore, në dispozicion të KQZ-së, ose palëve të treta që nuk promovojnë fushatën e një subjekti, të caktuar zgjedhor, por që i shërbejnë edukimit të zgjedhësve, lidhur me të drejtat e tyre dhe procedurat e regjistrimit dhe të votimit sipas Kodit Zgjedhor do të bëhet pranë ambienteve të çdo Njësie Administrative të Bashkisë Kurbin.

2. Në vendet e afishimit të percaktuara sipas pikës 1 të cituar më lart, subjektet zgjedhore lejohen të afishojnë vetëm materiale të programeve të tyre zgjedhore.

3. Gjatë fushatës zgjedhore përdorimi dhe afishimi i çdo materiali tjetër statik për propagandë zgjedhore, përfshirë flamujt dhe posterat, **lejohet vetëm në një largësi prej deri 5 metrash** nga zyra zgjedhore e partisë politike apo subjektit zgjedhor përkatës, këto vende do të jenë si me poshtë:

   Për Njësinë Administrative Laç: qendra e qytetit Bulevardi që përfshin segmenitn rrugor nga Zyra e Punës deri tek Komisariati i Policisë Kurbin, qyteti Laç.

   Për Njësinë Administrative Mamurras: qendra e Mamurrasit.

   Për Njësinë Administrative Milot: qendra e Milotit.

   Për Njësinë Administrative Fushë-Kuqe: qendra e Fushë Kuqes.

Ndalohet afishimi i materialeve propagandistike në: fasadat e godinave të banimit, institucioneve publike apo ambienteve rrethuese pranë e rreth tyre, brenda zonave rekreative, parqeve, në pemët e qytetit dhe në shtyllat e ndriçimit.

KRYETAR
Majlinda Cara

Adresa: Lagjia Nr.3, Laç , E-mail bashkiakurbin@gmail.com